VENDIM
Nr. 418, datë 7.7.2023

PËR MIRATIMIN E PROCEDURAVE PËR PËRZGJEDHJEN E PËRDORUESIT NË PARQET TEKNOLOGJIKE DHE SHKENCORE

(ndryshuar me VKM nr. 299, datë 28.5.2025)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 8, të ligjit nr. 58/2022, "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e parqeve teknologjike dhe shkencore", me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. PROCEDURAT PËR PËRZGJEDHJEN E PËRDORUESIT NË PARQET TEKNOLOGJIKE DHE SHKENCORE

1. Çdo person fizik ose juridik, shqiptar ose i huaj, mund të paraqesë te zhvilluesi kërkesën për miratimin si përdorues për të ushtruar aktivitet brenda parkut. Forma dhe mënyra e paraqitjes së kërkesës përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për ekonominë.

2. Kandidati për përdorues duhet të paraqesë bashkëlidhur kërkesës dokumentacionin e mëposhtëm:

a) ekstraktin e regjistrit tregtar për të dhënat e subjektit, si dhe ekstraktin për historikun e subjektit;

b) vetëdeklarimin se subjekti ka shlyer detyrimet tatimore dhe sigurimet shoqërore;

c) vetëdeklarimin që nuk është në ndjekje penale, si dhe nuk ka procese gjyqësore në lidhje me aktivitetin;

ç) vetëdeklarimin që nuk është në proces falimentimi dhe kapitalet e tij nuk janë në proces ekzekutimi nga përmbaruesit;

d) studimin e fizibilitetit për veprimtarinë që do të ushtrojë në park.

3. Kur kandidati për përdorues është person fizik, juridik, i huaj, duhet të paraqesë dokumentin zyrtar i cili vërteton se ofertuesi është i regjistruar në regjistrat përkatës tregtarë ose dokument të ngjashëm, të lëshuar nga institucionet përkatëse në shtetin e origjinës.

4. Dokumentet e siguruara jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë nga subjekte juridike të huaja duhet të jenë të notifikuara, në zbatim të legjislacionit në fuqi për ligjërimin e dokumentacionit të shtetasve të huaj që ushtrojnë veprimtari në Republikën e Shqipërisë.

5. Kandidati për përdorues nuk do të fitojë statusin e përdoruesit nëse i nënshtrohet një ose më shumë kufizimeve të mëposhtme:

a) shfuqizuar;

b) shfuqizuar;

c) në kapitalin e autorizuar të të cilit 25 për qind ose më shumë janë në pronësi të drejtpërdrejtë ose të tërthortë nga persona juridikë të regjistruar, të shpallur në listën e financuesve të terrorizmit;

ç) kur ai shpallet i falimentuar në përputhje me dispozitat në fuqi të ligjit për falimentimin;

d) kur është në proces likuidimi, përveç transformimit.

6. Zhvilluesi, në çdo rast kur miraton një përdorues, duhet të njoftojë institucionin përgjegjës, Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, njoftim i cili duhet të përmbajë kontratën e lidhur ndërmjet zhvilluesit dhe përdoruesit, dhe të dhënat për subjektin.

II. RASTET E ANULIMIT TË KONTRATËS NDËRMJET ZHVILLUESIT DHE PËRDORUESIT

1. Institucioni përgjegjës ngarkon zhvilluesin për marrjen e masave për anulimin e menjëhershëm të kontratës ndërmjet zhvilluesit dhe përdoruesit brenda parkut, kur vërtetohet se:

a) përdoruesi ka kryer evazion fiskal, duke deklaruar të ardhurat e krijuara nga veprimtaritë jashtë parkut si të ardhura të fituara në park ose duke paraqitur informacion të rremë për këtë qëllim;

b) mallrat kanë dalë nga parku në kundërshtim me Kodin Doganor dhe kur ka mospërputhje midis inventarit të mallrave brenda në park dhe të dhënave në regjistrin e stokut aktual;

c) përdoruesi gjatë zhvillimit të aktivitetit të tij nuk ka zbatuar për punonjësit legjislacionin në fuqi për punën.

2. Institucioni përgjegjës, në çdo rast të pezullimit të aktivitetit të përdoruesit ose anulimit të kontratës, duhet të njoftojë Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve për revokimin e lehtësirave fiskale dhe doganore.

3. Zhvilluesi duhet të raportojë pranë institucionit përgjegjës për kontratat e lidhura me përdoruesit, vlerën e investimit dhe numrin e punonjësve të siguruar.

III. DISPOZITA TË FUNDIT

Ngarkohet Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku